

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pak ditë pas komandimit në krye të SHISH: Elvis Lila do të merret në pyetje nga SPAK?
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1394170.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 20:13:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	25 shtator 2026, 20:04:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 25 shtator 2026, 20:03:00 UTC → 25 shtator 2026, 20:05:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c5f5a95c5fc98a5212896a9c22f231ab65ff527db18373eb814ab2783d102ec7f
TEKSTI	7e312d51a4deda0e56756605c11e9f319d1464d2eb6922b0ece6274dad1c9a2e
PAMJA	7a859dfad71dbb6e8d07e862921572f37159852dfb1c628c10b74d178b01706c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4168095fbb6190c55d1210d2ffae3f0a51438e92f57494d2df9a124a51a3f1f4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4168095fbb6190c55d1210d2ffae3f0a51438e92f57494d2df9a124a51a3f1f4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Pak ditë pas komandimit në krye të SHISH: Elvis Lila do të merret në pyetje nga SPAK?

Shkruar nga: M Gjini | Publikuar më: 25.09.2026, 22:04

Share

Share



Veprimtaria e Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH) është përfshirë nga zhvillime të bujshme hetimore. Drejtori i sapokomanduar i SHISH-it, Elvis Lila, si dhe Drejtori i Operacioneve në këtë institucion, Jurgen Kola, pritet të merren në pyetje nga Prokuroria e Posaçme (SPAK) brenda ditëve të ardhshme në kuadër të një dosjeje hetimore të klasifikuar "Top Secret", raportojnë mediat.

Sipas raportimeve të mediave, dy zyrtarët e lartë dyshohet se kanë lënë gjurmë gjatë veprimeve të tyre operativ-terrenore dhe në komunikime zyrtare, lidhur me përdorimin e mundshëm të aseteve të shërbimit sekret në dobi të grupeve kriminale.

Dyshime për fshirje të të dhënave nga serverët

Lajmi për hetimet ndaj krerëve të SHISH-it shoqërohet edhe me dyshime për ndërhyrje direkte në sistemet informatike të institucionit. Dyshohet se në zyrat e SHISH-it ka pasur përpjekje për fshirjen e të dhënave dhe provave nga kompjuterët zyrtarë. Sidoqoftë, raportohet se të dhënat mbeten të rikuperueshme përmes kopjeve të sigurisë (*backup*) dhe se regjistrimet në kohë reale janë të ruajtura në serverë të sigurt.

Arrestimi i Vlora Hysenit dhe lidhja me Ergys Agasin

Marrja në pyetje e drejtuesve të rinj vjen menjëherë pas arrestimit të ish-drejtoreshes së SHISH, Vlora Hyseni, e cila akuzohet si bashkëpunëtore e Ergys Agasit, i konsideruar nga hetuesit si drejtues i një grupi të strukturuar kriminal të lidhur me AKSHI-n. E menjëhershme pas këtij arrestimi ishte edhe lëvizja e kryeministrit Edi Rama, i cili komandoi Elvis Lilen në krye të detyrës deri në emërimin e titullarit të ri.

Akuzat e opozitës ndaj Jurgen Kolës

Emri i drejtorit operativ, Jurgen Kola, ishte denoncuar publikisht vetëm pak ditë më parë, më 23 shtator, nga kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha. Në një dalje për mediat, Berisha e cilësoi Kolën si një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit.

Sipas deklaratave të Berishës, takimet mes Hysenit dhe Agasit zhvilloheshin në një lokal në pronësi të Kolës në zonën e Bërzhitës. Kryetari i opozitës pretendon se kamerat e sigurisë së këtij lokali janë fshirë qëllimisht për të fshehur provat e takimeve, ndërsa u bëri thirrje publike hetuesve të SPAK-ut të verifikojnë pasuritë e tij në Arbanë dhe të hetojnë rolin e tij në këtë dosje.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.